



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 024

**PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT NR.1 TË MARRËVESHJES
TË LIDHUR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE QEVERISË HUNGAREZE NË LIDHJE ME PROGRAMIN
KORNIZË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT NR.1 TË
MARRËVESHJES TË LIDHUR NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË HUNGAREZE NË
LIDHJE ME PROGRAMIN KORNIZË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR**

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim që të ratifikojë Amendamentin Nr.1 të Marrëveshjes të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në Lidhje me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar, e nënshkruar më 14 Dhjetor 2016.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij Ligji ratifikohet Amendamenti Nr.1 i marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në lidhje me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar, e nënshkruar më 14 Dhjetor 2016.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij Ligji është i bashkëngjitur Amendamenti Nr. 1 të Marrëveshjes lidhur me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-024
12 gusht 2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës